



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)**

Nr. _____ Prot

Kruje me 10.07.2025

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME
ME
OBJEKT**

**LOTI NR.2-SHERBIME MEKANIKE PER MJETET MOTORIKE TE SEKTORIT TE
MZSH BASHKIA KRUJE.**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date _____.2025 ne Kruje prane Zyres se Prokurimeve , nga ana e Njesise se Prokurimit te caktuar me urdherin nr.235 datë 10.07.2025 , te Titullarit te AK , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit “E Hapur e Thjeshtuar”, me te dhenat e objektit te prokurimit si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Loti nr.2-Sherbime Mekanike per Mjetet Motorike te Sektorit te MZSH Bashkia Kruje.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Pjese kembimi per motore / (34312000-7).**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5’121’142 (pese milion e njeqind e njezet e nje mije e njeqind e dyzet e dy leke) pa t.v.sh .

BURIMI I FINANCIMIT:Te ardhurat e Bashkise Kruje dhe Transferta Specifike.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne vleren prej 2 % te fondit limit qe prokurohet)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2025 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator)*

Shenim-Per të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.10, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2025 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator).*

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5 në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b,

c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a) Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 9 te ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**) pikat,1;2.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

*2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **40 % e vleres e fondit limit te kontrates kontrates /lotit nr.2(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron”).***

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratave të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77 të LPP , si edhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron),** që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruar nga të dyja palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

3-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë:

- Nje inxhinier mekanik (1)

Per inxhinierin si me siper duhet te paraqesi kontratë pune te vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe librezë e punës.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. **285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës me kompetenca teknike për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimeve e pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e tyre dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar ne raport me shërbimet qe kerkohen te realizohen te cilat jane te profilit mekanik. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës te afte profesionalisht per realizimin e objektit.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

4-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- (një) motorrist
- (një) xhenerik
- (nje) elektroauto

Për cdo profil punonjesi teknik si me siper duhet të paraqitet, duhet të paraqitet si dokuemtacion provues :

- kontrata individuale të punës e vlefshme pergjate gjithë peridhes se afatit te realizimit te sherbimit ;
- një dokument te vlefshem që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/ akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar .

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërise, etj eshte e nevojshme pajisja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, vertetuar kjo ne baze te legjislacionit te punes e të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar” për realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve qe kane nevojë per kryerjen e shërbimeve si dhe natyren dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes te afte profesionalisht per realizimin e objektit.

5-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

- a) paisje për diagnostifikimin e defekteve te mjeteve (1)(nje).
- b) paisje urë ngritese për automjetet, të paktën 1 (një) urë;
- c) paisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit (1)(nje)(konvergjence).

Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat provuese që vërtetojnë se, këto pajisje/mjete apo instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje sipas rastit , ku perfshihen (fatura tatimore te blerjes / akte zhdoganimi / kontrata qiraje e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontrata huapërdorje e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Legjislacionit perkates ne Republiken e Shqiperise).

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me

nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku nje pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njërëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është cmuar si e nevojshme zotërimi i makinerive të sipërmëndura nga OE, të domosdoshme për riparimin dhe mirembajtjen e automjeteve. Referuar natyrës së objektit të prokurimit riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pasja e nje sërë pajisjesh dhe makinerish. Duke u bazuar në numrin e automjeteve që disponon AK si dhe llojet e shërbimeve që kërkohen te kryhen janë kërkuar të gjitha pajisjet e nevojshme.

Makinerite e pajisjet te cilat jane kerkuar si me sipër nga ana e AK jane te nevojshme per te kryer proceset specifike te punes qe kerkon ekzekutimi me sukses i objektit te kontrates, pasi ne zerat respektiv te preventivit jane parashikuar procese te tilla qe kerkojne angazhimin e ketyre makinerive dhe pajisjeve.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoj(ne pronesi /me qera/huapërdorje), ambjent per ushtrimin te aktivitet te tij (lidhur me riparimin e mirembajtjen e automjeteve), ne nje siperfaqe ku te perfshihen parkimi mjeteve + servisi + magazina pjeseve te kembimit + ambjente sherbimi te jashtme ne funksion te aktivitetit riparim te automjeteve).

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese sipas rastit:

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë, Certifikata e pronësisë, e lëshuar nga autoriteti kompetent ose, kontrata e shitblerjes; ose, kontrata e dhurimit; ose, çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:Kontratën respektive (te vlefshme pergjate gjithe periudhes se afatit te realizimit te sherbimit) te siperfaqes qe zoteron.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:Kontratë qiraje(te vlefshme pergjate gjithe periudhes se afatit te realizimit te sherbimit) te siperfaqes qe zoteron.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi-Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

b)-Ne rast difekti dhe pamundesie per te derguar mjetin për shërbim ne servis , operatori ekonomik duhet te ofroje per mjetet e **Bashkise Kruje/Sektorit te MZSH** , sherbim rimorkimi apo karroatrecei ne vendin ku ndodhet mjeti i dëmtuar (Deklarate nga administratori i shoqerise).

Argumentimi-Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga Specialiste te Sektorit te MZSH dhe Bashkise Kruje te cilet kane hartuar edhe elementet e tjere plotesues te dokumentacionit teknik te dokumentacionit perkates te ekzekutimit te kontrates duke qene elemente perberes te tij dhe qe jane administruar nga ana e Njesise se Prokurimit Publik me shkresen **nr. _____ prot date _____ .2025** . Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se mirmbajtjes dhe qarkullimit te mjeteve ne Republiken e Shqiperise
Me anë të kësaj procedure synohet mbajtja në gadishmëri teknike e automjeteve të transportit që ka në përdorim Sektori i MZSH Bashkia Kruje dhe konkretisht në procedurë janë përfshirë gjithsej 3(tre) mjete motorike , të llojeve të ndryshme,sipas natyres dhe funksionit speicifik.

Zërat e shërbimeve janë hartuar bazuar në llojet e mjeteve në përdorim/shërbim të Sektorit të MZSH Bashkia Krujë referuar shërbimeve të parashikuara në një periudhë të afërt dhe mundësisë të defekteve të ndodhura nga përvoja e viteve të shkuara.

Referenca ligjore për specifikimet teknike: neni 36, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Specifikimet Teknike dhe Termat e References janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

- **Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të kërkesave specifike të nenit 34 të Ligjit nr 162/2020 ‘‘Për Prokurimin Publik’’ dhe nenit 76.1. të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ‘‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’’.** Cmimet reference të preventivit për çdo ze janë marrë referuar testimit të tregut për shërbimet e ngjashëm komponente të preventivit të shërbimit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët ‘‘ose ekuivalenti i tij/saj’’.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët ‘‘ose ekuivalente’’.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK